



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:030501
Datë: 16.10.2024
Numri i dokumentit: 06308825

A.nr.315/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit V. A. nga Prishtina, Rr. "B..." nr...., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. Sh. nga Prishtina, kundër të paditurve; Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R. K. dhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me seli në Prishtinë, të cilin sipas ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, me bazë juridike anulimin e vendimit A.nr.14/2022 i datës 02.02.2022, me kërkesë për kompensim të shtesës mbi pagën bazë, pas mbajtjes të seancës të shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe të autorizuarit të paditurit të parë si dhe në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurës, me datë 20.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditësit V. A. nga Prishtina, Rr."..." Nr...., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B. Sh. nga Prishtina.
- II. **ANULOHET** vendimi me nr. A.nr.14/2022 i datës 02.02.2022 i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, **si i kundërligjshëm**.
- III. **DETYROHET** i padituri Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me seli në Prishtinë që paditësit V. A. nga Prishtina, Rr."B..."..., në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës t'ia paguaj paditës nga data 23.06.2020, në shumën mujore prej 300€, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e kësaj shtese, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtimit të padisë në gjykatë 15.02.2022 për secilën kërkesë mujore të arritur për pagesë, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- IV. Ky aktgjykim e zëvendëson vendimin e Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr.A.nr.14/2022 të datës 02.02.2022.
- V. **REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, përkatësisht refuzohet kërkesa për kompensim në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës nga data 05.03.2020 deri me datë 22.06.2020, në shumën mujore të kërkuar prej 400€, dhe kërkesa për kompensim në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës nga data 23.06.2020, deri sa të

ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e kësaj shtese në shumën mujore shtesë prej 100€.

VI. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me vendimin e kontestuar me nr. A.nr.14/2022 të datës 02.02.2022, i padituri i parë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin në vijim KPMSHCK), duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1757/20 të datës 24.12.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr.A.nr.230/2020 të datës 13.08.2020, të parashtruar nga ankuesi V. A., këtu paditësi lidhur me mos pagesën e shtesës në pagë për kuadër deficitar.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e kontestuar, me padinë e paraqitur në gjykatë me datë 15.02.2022, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit KPMSHCK, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, respektivisht MPB, që paditësit ti paguhet në mënyrë retroaktive shtesa mbi pagën bazë e përcaktuar sipas vendimit nr.02/39 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që nga data e parashtrimit të kërkesës në MPB, dhe të obligohet i padituri KPMSHCK-MPB, që në emër të dëmit material për shkak të mos njohjes së të drejtës në shtesa mbi pagën bazë, paditësit t'ia paguaj shumën prej 400€ në muaj, për muajt që nga parashtrimi i kërkesës në MPB, si dhe kamatën ligjore prej 8%.

Me parashtrësën e datës 11.04.2024 të pranuar në gjykatë, paditësi ka bërë rregullimin e padisë ashtu që krahas KPMSHCK-së ka paditur edhe Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve-punëdhënës in e tij, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i KPMSHCK me nr.A.nr.14/2022 i datës 02.02.2022 dhe të detyrohet AKK, që në emër të shtesës sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/39 të datës 08.10.2008, për shtesa në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, ti paguaj shtesën në pagë për periudhën 05.03.2020 e deri në momentin e precizimit të kërkesëpadisë 11.04.2024, në lartësi prej 49 muaj, në shumën prej 400.00€ për një muaj apo në total 19,600.00€.

Përgjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare paditësi përmes të autorizuarit ka deklaruar se qëndroj në tërësi pran padisë, precizimit të padisë dhe kërkesëpadisë, të paraqitur me shkrim pran kësaj gjykate, duke propozuar që pas administrimit të provave të cilat i janë bashkangjitur padisë, padinë dhe kërkesëpadinë që ka të bëjë me anulimin e vendimit të KPMSHCK-së me nr.14/2022 të dt.02.02.2022, si dhe aprovimin e kompensimit financiar për shtesën profesionale për IT, të cilat janë mbështetur nga institucioni nga vjen paditësi, mirëpo në realitet nuk i kanë realizuar. Ka cekur se po ashtu bazuar edhe në Ligjin për Diskriminim, pasi që në raste të njëjta në Institucionet e Kosovës ju paguhet kjo shtesë, kërkoj që edhe paditësit ti aprovohet e njëjta. Ka shtuar se meqenëse në precizimin e kërkesëpadisë është kërkuar që të detyrohet e paditura e dytë që paditësit t'ia paguaj shtesat në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare nga data 05.03.2020 e deri me dt.11.04.2024 në shumat mujore prej 400€, në këtë seancë pasi që ka kaluar një kohë nga precizimi i kërkesëpadisë, kërkoj që e paditura të obligohet në pagesën e shtesës së përmendur nga data 05.03.2020 e deri sa te ekzistojnë kushtet ligjore për pagesën e kësaj shtesë në shumën mujore prej 400€.

I padituri Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në përgjigjen në padi të datës 09.12.2022, e ka kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar. Ka theksuar se KPMSHCK/Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar vendimin nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informative dhe inxhinieringut, dhe vendimin nr.07/29 të datës 31.08.2007 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin

dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për kategoritë deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Ka vijuar se bazuar në dispozitat e Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka konstatuar se ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkoj nga Qeveria që të miratoj një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40%, më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet ti ofroj ministrisë përgjegjëse për administratë publike, kërkesën lidhur me arsyeshmerinë e realizimit të shtesë dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushtet e veçanta të tregut nuk mund të tejkaloj më shumë se 50% të pagesë bazë.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurit KPMSHCK ka deklaruar se mbetem pran përgjigjes në padi, deklarimeve të sotme pran seancë, me propozim që gjykata ta refuzoj padinë e paditësit, për arsye se, nga data 24.12.2012 është aprovuar rregullorja për shtesa dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil e rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje janë shfuqizuar vendimet paraprake të Qeverisë në lidhje me shtesat e kësaj natyre. Andaj mbi bazën e kësaj gjykatës i ka propozuar që të nxjerr aktgjykim me të cilin ta refuzoj padinë e paditësit si të pa bazuar në ligj duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

I padituri i dytë AKK, përmes përfaqësues ligjore MD-Avokatura Shtetërore në përgjigjen në padi të datës 25.07.2024 ka deklaruar se e kontestojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar. Ka cekur se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare. Ka theksuar se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë andaj i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin e refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe e lë në fuqi vendimin si të ligjshëm.

Gjykata në seancën gjyqësore të shqyrtimit kryesor të datës 20.09.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurit të dytë, MD-Avokaturës Shtetërore të ftuar në mënyrë të rregullt.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 2.05.2024, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi i KPMSHCK A nr.14/22 i dt. 02.02.2022, Korrespondenca me emaili e dt.31.02.2022, Aktgjykimi i kësaj gjykate A.nr. 1757/20 i dt. 24.12.2021, Njoftimi i KPMSHCK-së lidhur me ankesën i dt.05.10.2020, Përgjigja e dt.04.09.2020, Kërkesa e paditësit për njohjen e të drejtës së kompensimit për shtesa e dorëzuar në KPMSHCK e datës 13.08.2020, Kërkesa për miratimin e shtesës së TI e dt. 22.06.2020, Vendimi i Qeverisë së RKS-së me aneks me nr.02/39 i dt. 08.10.2008, Akt emërimi i paditësit i dt.05.03.2020, Vendimi për njohjen e përvojës se punës për paditësin me nr. 02-106 i dt.05.03.2002, Konkursi për plotësimin e vendit të lire të punës për pozitën zyrtar i larte për teknologji informative dhe logjistike i publikuar nga punëdhënësi i paditësit, Diploma e studimeve e paditësit me nr.163/13 e dt.29.07.2013, Vendimi i Qeverisë së RKS-së me nr.07/29 i dt.31.07.2008, Rekomandimi i komisionit për pozitat që duhet të kategorizohen me shtesa i dt.10.10.2023, Kërkesa për miratim të shtesës me nr. prot 02/698 e dt. 10.11.2023, Kërkesa për aprovimin e pozitave dhe shtesave në pagë me nr. prot

619 e datës 06.02.2014, Shkresa me nr. prot. 3666 e dt.02.07.2014, Raporti i punës së KPMSHCK-së për vitin 2017.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara, por edhe pohimet e palëve ndërgjyqëse gjykatës i rezultuan të jenë disa fakte të pa kontestuara. Ndër to se paditësi e ka themeluar marrëdhënien e punës me të paditurin Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve sipas akt emërimit të datës 05.03.2020, në pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative dhe Logjistikë, me koeficient 8, pa afat. Nuk ishte kontestuese as që paditësi ka kryer studimet themelore universitare në Kolegjin “Iliria” në Prishtinë duke marr titullin Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë sipas diplomës me nr.163/13 të datës 29.07.2013 të lëshuar nga ky institucion. Gjithashtu nuk ishte kontestuese as që kjo gjykatë me aktgjykimin A.nr.1757/20 të datës 24.12.2021 kishte aprovuar si të bazuar padinë e paditësit, ka anuluar aktin administrativ/njoftimin e të paditurit A.nr.1974/2020 të datës 05.10.2020, duke e detyruar të paditurin-KPMSHCK që në afat prej 30 ditësh të merr aktvendim sipas ankesës së paditësit A.nr.1974/2020 të datës 13.08.2020. Nuk ishte kontestuese as fakti që organi i punësimit i paditësit, këtu i padituri i dytë AKK, me kërkesat e datë 22.06.2020, 11.05.2021 dhe 10.11.2023, drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut dhe MPB-së, ka kërkuar miratimin e shtesës në pagë për paditësin, duke u bazuar në Rregulloren nr.33/2012 për Shtesa në Pagë dhe Kompensime Tjera të Nëpunësve Civil si dhe Vendimit nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht me shkresën e datës 10.11.2023 kishte propozuar që shtesa për paditësit të jetë 300€.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse në këtë procedurë gjyqësore, respektivisht në mes paditësit dhe të paditurit të parë nëse paditësit bazuar në dispozitat e Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil si dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/39 të datës 08.10.2008, i takon shtesa mbi pagën bazë për kushtet e tregut nga data e nënshkrimit të akt emërimit 05.03.2022, nëse po në çfarë shume, dhe nëse me rastin e mos pagesës së kësaj shtese paditësit, ka pasur diskriminim.

Nga shkresa e emërtuar Miratimi i shtesë në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare-Universiteti “Kadi Zeka” në Gjilan me nr. protokolli 3666 e datës 02.07.2014 e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike-Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, rezulton se ky komision duke u bazuar në vendimin e Qeverisë nr.02/39 të datës 08.10.2008, ka aprovuar kërkesën e paraqitur nga Universiteti Kadi Zeka” në Gjilan për një pozitë administrator i rrjetit-specialist i TI në shumë prej 200€ dhe për një pozitë administrator i bazës së të dhënave-specialist i TI në shumë prej 200€.

Nga shkresa e emërtuar kërkesë për aprovimin e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare-Agjencia e Kosovës për Akreditim-MASHT, me nr.protokolli 619 e datës 06.02.2014, gjykata gjeti se Komisioni për Shqyrtimin dhe Miratimin e Pozitave dhe Shtesave në Pagë për Kategori të Veçantë të Profesioneve Deficitare, duke u bazuar në vendimin e Qeverisë nr.02/39 të datës 08.10.2008, ka aprovuar shtesën për një pozitë Zyrtar për Publikime, web dhe TI-specialist i TI në shumë prej 200€.

Nga vendimi i kontestuar i KPMSHCK me nr.A.nr.14/2022 i datës 02.02.2022, gjykata e ka konstatuar faktin se i padituri KPMSHCK, duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.1757/20 të datës 24.12.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr.A.nr.230/2020 të datës 13.08.2020, të parashtruar nga paditësi lidhur me mos pagesën e shtesës në pagë për kuadër deficitare nga

organi i punësimit. I padituri në vendimin e kontestuar në mes tjerash ka theksuar se Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka konstatuar se ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkoj nga Qeveria që të miratoj një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40%, më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet ti ofroj ministrisë përgjegjëse për administratë publike, kërkesën lidhur me arsyeshmerinë e realizimit të shtesë dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushtet e veçanta të tregut nuk mund të tejkaloj më shumë se 50% të pagesë bazë. Ka shtuar se kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 par.2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6 par.1 nën par.1.1 dhe nenin 18 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit nr.06/L-048 për KPMSHCK, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga vendimi me nr.protokolli 02-106 i datës 05.03.2022 i lëshuar nga autoriteti i punësimit të paditësit/AKK rezultoi se ky institucion ka konstatuar se paditësi si zyrtar i lartë për teknologji informative në AKK i ka gjithsej 6 vite përvojë pune deri në datën e lëshimit të këtij vendimi.

Nga Rekomandimet e Komisionit për Pozitat që Duhet të Kategorizohen me Shtesa, përkatësisht të Komisionit për vlerësimin e sistemeve të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike i datës 10.10.2023, gjykata konstaton se ky komision ka rekomanduar pozitat e institucioneve që posedojnë sisteme shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike, të trajtohen me prioritet dhe të kategorizohen më mirë me shtesa në krahasim me institucionet e tjera, duke e renditur të paditurin AKK në rubrikën nr.9, për një pozitë Zyrtar i Lartë i Teknologjisë Informative, me kategorizim të pozitës shtesat sipas kushteve të tregut të punës.

Me vendimin nr.02/39 të datës 08.10.2008, Qeveria e Republikës së Kosovës në pikën I të tij, ka vendosur që të miratohet lista e pozitave dhe shtesave në paga, për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e teknologjisë informative dhe inzhinieringut, në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës, sipas aneksit 1 të këtij, kurse në pikën II të tij ka vendosur që zbatimi i aneksit 1, duhet të bëhet në pajtim me vendimin e Qeverisë nr.07/29 të datës 31.07.2008. Në aneksin I të këtij vendimi është bërë lista dhe titujt e punonjëse që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita. Ky kategorizim në këtë listë fillon me pozitën Menaxher i nivelit të lartë I, Menaxher i nivelit të dytë II dhe Menaxheri i nivelit të tretë III. Tek pozita menaxher II, ku pretendon se paditësi bën pjesë si kriter përcaktohet diploma përkatëse universitare & certifikatat profesionale përkatëse, përvoja e punës profesionale përkatëse, kurse niveli i përgjegjësisë rezultoi me përgjegjësi në menaxhimin e TI-së në institucione të rëndësishme të qeverisë të cilat kanë sisteme të izoluara, por me rëndësi të veçantë siç janë: MEF, MSHP, MPB, Doganat, ATK, institucionet e tjera. Për kategori është paraparë përgjegjësia në menaxhimin e TI-së në institucione të rëndësishme të qeverisë të cilat kanë sisteme të izoluara, por me rëndësi të veçantë.

Me vendimin me nr.07/29 të datës 31.07.2008, të Qeverisë të Republikës së Kosovës për miratimin e shtesave në paga për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës në pikën 1 të tij është vendosur që “1. Të gjitha organizatat buxhetore propozimet për shtesa në paga për kategori të veçanta deficitare dhe për punonjës të veçantë i bëjnë në Ministrinë e Shërbimeve Publike/DASHC”. Në pikën 2 të këtij vendimi është vendosur që “2.Propozimet lidhur me

shtesat në paga për ruajtjen e punonjësve iniciohen nga zyrtari kryesor administrativ i organizatës buxhetore përkatëse në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”. Në pikën 3 të vendimit është vendosur “Ministria e Shërbimeve Publike në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave përgatisin listën dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të shtesave në pagë, duke përfshirë edhe shumën për këto pozita, në afat prej 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi”. Në vazhdim në pikën 6 të këtij vendimi thuhet se “Ministria e Shërbimeve Publike në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, shqyrton kohë pas kohe listën dhe standardet kualifikuese dhe shumën e masës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjashtë muaj”.

Në nenin 44 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës nr.03/L-149 është përcaktuar se “Puna e nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave, i cili rregullohet me ligj të veçantë”. Në nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili ligj ka qenë në fuqi deri me hyrjen e Ligjit për Paga nr.08/L-196 me datë 05.02.2023, është paraparë “1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil”. Kurse në nenin 14 të këtij ligji është përcaktuar se “Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1.shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut”. Në vazhdim në nenin 17 të ligjit të njëjtë është paraparë “1. Për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është shumë më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit për ato pozita ose lloje të pozitave nga administrata publike, ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitave. 2. Kërkesa për miratimin e kësaj shtese nga Qeveria duhet të bazohet në një analizë, e cila tregon se për këto pozita ose lloje të pozitave: 7 2.1. çmimi i tregut për aftësitë në fjalë është shumë më i lartë se paga që ofrohet nga Shërbimi Civil; 2.2. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve është e papranueshme; 2.3. pritet se shtesa do të ndikojë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit. 3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e shumës së shtesave mbi pagën bazë për kushtet e tregut përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa”.

Në nenin 8 të Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil është përcaktuar “Për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave nga administrata publike, Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitave. 2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut, institucioni duhet t’i ofrojë ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën që përmban: 2.1 Arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut për pozitën përkatëse, së bashku me një analizë, e cila dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, duke përfshirë informata mbi nivelin e pagës që paguhet nga organizatat e tjera në tregun e Kosovës për pozita të ngjashme. 2.2 Listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë dhe 2.3 Koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushtet e tregut të punës. 3. Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Financa pas shqyrtimit të kërkesës, mund: 3.1. Të aprovojë shtesat për pozitat përkatëse dhe t’i propozojë Qeverisë për miratim; 3.2. T’i propozojë institucionit ndryshim/plotësime eventuale të kërkesës së parashtruar; 3.3. Të refuzojë kërkesën me arsyetim. 4. Shuma e shtesë mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë. 5. Shtesa

për secilën pozitë ose lloj të pozitës mund të ofrohet për një periudhë maksimale prej 12 muajve. Para përfundimit të kësaj periudhe 12 mujore, institucioni mund të dorëzojë kërkesë për një shtesë të re, për kushte specifike të tregut, përmes procedurës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni”. Në nenin 23 të kësaj rregullore është përcaktuar “Të gjitha aktet nënligjore që rregullojnë shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civilë që nuk janë në pajtim me ketë rregullore shfuqizohen dhe duhet të harmonizohen me ketë rregullore më së largu 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi”.

Në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.08/48 të datës 09.09.2015 për rishikimin e ndarjes së shtesave të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pikën 1, nën pika 1.1 të tij është vendosur që “1.Të gjitha shtesat të cilat realizohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës me vendime të veçanta nga institucionet e ndryshme do të ri shqyrtohen deri me 15.10.2015 dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas kësaj procedure; 1.1 Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe organet vartëse të tyre të cilat kanë propozuar vendime të Qeverisë për shtesa, e të cilat janë aprovuar nga Qeveria, duhet të bëjnë kërkesë për ndryshim, plotësimin apo vazhdimin e tyre”. Në pikën tre të vendimit thuhej që “Përfituesit e shtesave do të përcaktohen me vendim. Kërkesat për përfituesit do të shqyrtohen dhe miratohen paraprakisht nga komisioni i përbashkët i themeluar nga Ministria e Administratës publike dhe Ministria e Financave”.

Në Ligjin nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.02.2024, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO79/23, i datës 23.01.2024, nenin 24 par.1, 3, dhe 4 është paraparë se “1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për profesione të nevojshme, në pozita të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur.3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut të punës për nëpunësen/in civile dhe nëpunësen/in e/i shërbimit publik, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për financa. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut për nëpunës të shërbimit civil rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet”.

Me rregulloren (MFPT) NR. 02/2023 Për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës e cila ka hyrë në fuqi me datë 07.02.2023 me publikimin në gazetën zyrtare, në nenin 4 të saj është paraparë se “ 1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për pozita të caktuara deficitare dhe të rralla të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur ose ka vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin ose mbajtjen e personelit të kualifikuar të atyre pozitave. 2. Shtesa për kushte të tregut të punës mund të përfitohet kur plotësohen kumulativisht kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, kur kriteret e veçanta aplikohen për secilin profesion deficitar. 3. Kriteret e përgjithshme, janë si në vijim: 3.1. nëpunësi civil apo nëpunësi i shërbimit publik është i punësuar në pozita specifike profesionale, drejtuese, si dhe specialistët; 3.2. rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve në këto pozita specifike për shkak të kualifikimeve të mbajtësit të pozitës krijon vështirësi për shkak se tregu privat ofron paga dukshëm më të larta se sektori publik; 3.3. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve krijon probleme në funksionimin e rregullt të njërive administrative. 4. Profesionet për të cilat mund të përfitohet shtesa për kushte të tregut të punës janë: 4.1.profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative; 4.2. profesionet deficitare në fushën e aviacionit dhe navigimit ajror; 4.3.profesionet nga programet studimore të financuara ose bashkë-financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës; 4.4.specialistët shëndetësor në profesione deficitare, ashtu siç përcaktohen nga ministria përkatëse për shëndetësi; si dhe 4.5.pozita tjera të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunësve/ve me pagat e rregullta në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur”. Në vijim në nenin 5 të kësaj rregullore është përcaktuar “1. Varësisht nga kualifikimi, natyra dhe kompleksiteti i punës, domosdoshmërisë për mbajtjen e personit në sektor publik, të punësuarit në

fushën e teknologjisë informative kanë të drejtë të marrin shtesë mujore për kushte të tregut të punës. 2. Kriteret e veçanta për të përfitur shtesën për kushte të tregut të punës për të punësuarit në fushën e teknologjisë informative janë: 2.1. të kenë përvojë pune profesionale në fushën e teknologjisë informative; 2.2. të kenë vlerësim mbi notën “mirë” të performancës; 2.3. të mos ketë masë disiplinore aktive për shkelje të rënda; 2.4. institucioni duhet të ketë strategji të Teknologjisë Informative të aprovuar; 2.5. institucioni të posedojë plan operacional të aplikimit të Strategjisë së TI-së bazuar në objektiva të qarta dhe të matshme strategjike, duke përfshirë raportimin e matjeve dhe monitorimit”.

Në nenin 10 të kësaj rregullore procedura për përfitimin e shtesës për kushte të tregut të punës është paraparë se “1. Për përfitimin e shtesës sipas kësaj Rregulloreje, Ministria përgjegjëse për Financa themelon Komision me mandat tre (3) vjeçar, në përbërje si në vijim: 1.1. Dy (2) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa; dhe 1.2. Një (1) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për administratë publike. 2. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore e secilit institucion përgatitë listën e të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret e kësaj Rregullore dhe e përcjellë atë tek Komisioni sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. 3. Lista e të punësuarve, sipas paragrafit 2 të kësaj Rregulloreje, duhet të përmbajë të dhënat si në vijim: 3.1.emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil; 3.2.pozitën e nëpunësit civil; 3.3.përshkrimin e detyrave të punës; dhe 3.4.propozimin e arsyetuar për nivelin e shtesës. 4.Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë: 4.1. të njoftoj dhe bashkëpunoj me institucionet që kanë të punësuar nga kategoritë e përcaktuara me këtë Rregullore; 4.2.të bëj verifikimin nëse profesioni dhe/ose pozita për të cilën kërkohet miratimi i shtesës plotëson kushtet e përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje; 4.3.propozoj institucionit ndryshim/plotësime eventuale të kërkesës së parashtruar; 4.4.në rastet kur vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore, refuzon kërkesën, duke arsyetuar vendimin; dhe 4.5.përgatitë listën finale, me pozitën, vlerat indikative të rekomanduara për secilën kategori me tabela/lista të ndara dhe çfarëdo informacioni tjetër që Komisioni e konsideron relevant duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, dhe ia rekomandon Ministrin përgjegjës për Financa për miratim”.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë cekur më lartë dhe dispozitave ligjore të cituara, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në ligj dhe fakte. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar gjykata vlerëson se organi i paditur KPMSCHK, në ri procedurë, me rastin e nxjerrjes së vendimit të atakuar me padi nr. A.nr.14/2022 të datës 02.02.2022, me të cilin paditësit i ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me nr.A.nr.230/2020 të datës 13.08.2020, për njohjen e të drejtës së kompensimit për shtesat për kuadrin deficitar, nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejt dispozitat ligjore në fuqi të cilat e kanë rregulluar çështjen e shtesës mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës.

Gjykata thekson se me vendimin nr.02/39 të datës 08.10.2008, Qeveria e Republikës së Kosovës në pikën I të tij është vendosur që të miratohet lista e pozitive dhe shtesave në paga, për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e teknologjisë informative dhe injnjeriut, në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës, sipas aneksit 1 të këtij, kurse në pikën II të tij ka vendosur që zbatimi i aneksit 1, duhet të bëhet në pajtim me vendimin e Qeverisë nr.07/29 të datës 31.07.2008, me të cilin vendim ishin miratuar shtesave në paga për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës. Më tej me Rregulloren nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil e cila ka hyrë në fuqi nga data 24.12.2012 është paraparë përsëri shtesa për kushtet e tregut, e cila do të shqyrtohej pas kërkesës nga institucioni punëdhënës, nga Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Financa. Tutje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.08/48 të datës 09.09.2015 për rishikimin e ndarjes së shtesave të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pikën 1, nën pika 1.1 të tij është vendosur që “1.Të gjitha shtesat të cilat realizohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës me vendime të veçanta nga institucionet e ndryshme do të ri shqyrtohen deri me 15.10.2015 dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas kësaj procedure; 1.1 Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe organet vartëse të tyre të cilat kanë propozuar vendime të Qeverisë për shtesa, e të cilat janë aprovuar nga

Qeveria, duhet të bëjnë kërkesë për ndryshim, plotësimin apo vazhdimin e tyre”. Në pikën tre të vendimit thuhej që “Përfituesit e shtesave do të përcaktohen me vendim. Kërkesat për përfituesit do të shqyrtohen dhe miratohen paraprakisht nga komisioni i përbashkët i themeluar nga Ministria e Administratës publike dhe Ministria e Financave”.

Përsëri me Ligjin nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.02.2024, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO79/23, i datës 23.01.2024, nenin 24 par.1, 3, dhe 4 është paraparë se “1. Shtesa për kushte të tregut të punës përfitohet për profesione të nevojshme, në pozita të caktuara profesionale deficitare të shërbimit civil dhe shërbimit publik, ku rekrutimi apo mbajtja e nëpunëseve/ve në këto profesione dhe/apo pozita objektivisht është e pamundur.3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Profesionet përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushtet e tregut të punës për nëpunësen/in civile dhe nëpunësen/in e/i shërbimit publik, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga ministria përgjegjëse për financa. Përfitimi i shtesës për kushtet e tregut të punës për shërbimit civil rishikohet të paktën çdo tre (3) vjet”. Bazuar në këtë ligji Ministria e Financave Ministria e Financave ka nxjerr Rregulloren (MFPT) NR. 02/2023 Për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës e cila ka hyrë në fuqi me datë 07.02.2023, e ku në nenin 4 dhe 5 të saj ka paraparë shtesat për kushtet e tregut të punës, respektivisht shtesa për kushte të tregut të punës për profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative. Gjykata thekson se kjo rregullore ka paraparë themelimin e një Komisioni me mandat 3 vjeçar i cili komisioni pranon listat e të punësuarave nga burimet njerëzore të së cilit institucion të cilët i plotësojnë kriteret për shtesat për kushtet e tregut të punës. Në këtë aspekt nga shkresat e lëndës gjykata thekson se ekziston rekomandimi i një Komisioni të tillë siç është ai i datës 10.10.2023, për pozitën për komisionin për shtesat për kushtet e tregut të punës, sipas të cilit është rekomanduar lista e pozitave për punonjësit e institucioneve e ku në mesin e tyre është edhe i padituri i dytë-Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me nr.rendor 39, respektivisht pozita e Zyrtarit të Lartë i Teknologjisë Informative.

Gjykata ri thekson se kompensimi i shtesave për kushte të tregut të punës për profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative është rregulluar që nga vendimi me nr.07/29 i datës 31.07.2008, i Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe se që nga ajo kohë këto shtesa i realizojnë personat të cilat punojnë në këto pozita, bazuar në kërkesat e organeve punëdhënësve të parashtruar në Ministrinë përkatëse, respektivisht Ministrinë e Administratës Publik-Departamentin e Administrimit të Shërbimit Civil dhe Ministrinë e Financave. Kjo u dëshmuar në këtë procedurë gjyqësore edhe përmes provave të bashkangjitura nga paditësi siç janë shkresat e Ministrisë së Administratës Publike me nr.protokolli 619 e datës 06.02.2014 dhe me nr.3666 e datës 02.07.2014, të administruara si prova nga gjykata, nga ku shihet se pikërisht bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.02/39 të datës 08.10.2008, ky institucion ka miratuar shtesat në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në fushën e Teknologjisë Informative.

Gjykata thekson se përkundër tri kërkesave të parashtruar nga organi punëdhënës i paditësit-AKK për miratim të shtesës së TI-së për pozitën-Zyrtar i lartë për Teknologji Informative dhe Logjistikë tek Komisioni për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës dhe gatishmërisë së organi punëdhënës të paditësit për pagesën e kësaj shtesë në vlerën prej 300€ në muaj, ky Komision dhe Ministria përgjegjëse kanë dështuar që të vendosin lidhur me këtë kërkesë. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se paditësi nuk mund të penalizohet dhe ti mohohet një e drejtë subjektive siç është e drejta në shtesë në pagë për kushte të tregut të punës për profesionet deficitare në fushën e teknologjisë informative, vetëm pse Komisioni për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës nuk ka lëshuar ndonjë akt për miratimin e shtesës sipas kërkesës së organit punëdhënës.

Kështu që gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka pasur trajtim të barabartë nga ana e Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës të Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, pasi që për disa punonjës të organizatave shtetërore buxhetore është miratuar shtesa në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e TI dhe të njëjtit e realizojnë këtë shtesë, kurse paditësi në këtë rast nuk e ka realizuar shtesën në pagë për kushte të tregut të punës për profesionet deficitare. Gjkata vlerëson se një gjë e tillë është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe si e tillë paraqet diskriminim të hapur i cili është i sanksionuar edhe sipas Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nr.05/L-021, pasi që institucionet përgjegjëse për shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës siç është Ministria e Administratës Publike deri sa ka ekzistuar ajo dhe më pastaj edhe Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me Ministrinë e Financave, nuk i kanë trajtuar në mënyrë të njëjtë, personat të cilat i ushtrojnë pozitat e kategorive të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e teknologjisë informative dhe inxhinieringut, sepse për një pjesë të tyre janë miratuar shtesat në pagë sipas kërkesave të institucioneve punëdhënëse, kurse për rastet e ngjashme sikurse në rastin e paditësit nuk është miratuar dhe paguar kjo shtesë.

Prandaj gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë të bazuara dhe të drejta sa i përket anulimit të vendimit të kontestuar të KPMSHCK-së me nr.A.nr.14/2022 të datës 02.02.2022, për shkak se, sipas vlerësimit të gjykatës ky është vendim i kundërligjshëm, sepse me rastin e nxjerrjes së tij nuk janë aplikuar drejt as dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase ky vendim fillimisht është nxjerr në shkelje të rregullave të procedurës administrative të përcaktuara me nenin 48, par.1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të LPPA-së nr.05/L-031, respektivisht të njëjtit në arsyetim i mungon shpjegimi i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; dhe baza ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret, e për të cilat shkaqet gjykata kujdeset zyrtarisht sipas nenit 44 të LKA-së. Arsyetimi i vendimit është dukshëm i pamjaftueshëm, është i mangët, dhe si ti tillë është i barabartë me mungesën e tij dhe kjo është përcaktuar shprehimisht në dispozitën e nenit 48 par.2 të LPPA-së. Së këndejmi gjykata e anuloi aktin administrativ të kontestuar të paditurit KPMSHCK me nr. A.nr.14/2022 të datës 02.02.2022.

Gjkata nga një gjendje e tillë e çështjes erdhi në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit për kompensim në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës është pjesërisht e bazuar dhe atë nga data 22.06.2020, kur organi punëdhënës i paditësit-AKK ka parashtruar kërkesë tek Divizioni i Divizionit të Politikave të Pagave dhe Organizimit në MPB, për miratimin e shtesës në pagë për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative dhe Logjistike, prandaj gjykata në dispozitivin III të këtij aktgjykimi e obligoj të paditurën e dytë AKK, që paditësit, në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës t'ia paguaj paditës nga data 23.06.2020, në shumën mujore prej 300€, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e kësaj shtese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë për të cilën gjykata ka vendosur në dispozitivin V të këtij aktgjykimi, gjykata vlerëson se nuk bazë ligjore kërkesa e paditësit për kompensim në emër të shtesës mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës nga data 05.03.2020 deri me datë 22.06.2020, sepse përkundër që paditësi e ka nënshkruar akt emërimin me punëdhënësin e tij AKK me datë 05.03.2020, me të cilin e ka themeluar marrëdhënien e punës për titullin e vendit të punës Zyrtar i lartë për teknologji informative dhe logjistike, me koeficient 8, nga data 06.03.2020, pa afat, paditësi nuk ka paraqitur dëshmi me të cilin provohet se organi punëdhënës i tij ka paraqitur kërkesë për miratimin e shtesës për kushtet e tregut të punës nga data 05.03.2020, siç është paraparë me vendimin me nr.07/29 të datës 31.07.2008, të Qeverisë të Republikës së Kosovës për miratimin e shtesave në paga për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës, nenin 17 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 8 të Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, për periudhën e lartcekur.

Gjykata nisur nga baza ligjore e sipërcituar thekson se realizimi i shtesës në emër të pagës për kushtet e tregut të punës në fushën e teknologjisë informative është i lidhur me kërkesën e organit punëdhënës, andaj për periudhën kur nuk ka pasur kërkesë për pagesën e kësaj shtese nga ana e organit punëdhënës të paditësit nuk ka bazë kërkesa për pagesën e të njëjtës, pasi që pagesa e kësaj shtese nuk është paraparë me akt emërimin e datës 05.03.2020, të nënshkruar në mes paditësit dhe punëdhënësit të tij-të paditurës të dytë AKK.

Gjykata gjithashtu në dispozitivin V të këtij aktgjykimi e refuzoj kërkesën për kompensim në emër të shtesës në mbi pagën bazë për kushtet e tregut të punës nga data 23.06.2020, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e kësaj shtese në shumën mujore shtesë prej 100€, sepse gjykata konstaton se organi i punësimit i paditësit me kërkesën për miratimin e shtesë së TI për pozitën Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative dhe Logjistike drejtuar Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës, ka propozuar që kjo shtesë për paditësin të aprovohet në shumën mujore prej 300€, e jo në shumën e kërkuar nga paditësi prej 400€ në muaj. Prandaj gjykata vlerësoj se nuk kërkesa për pagesën e shtesës për kushtet e tregut të punës mbi shumën mujore prej 300€ në muaj për periudhën nga data 23.06.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen dhe pagesën e kësaj shtese.

Në lidhje me kamatën gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, në pajtim me dispozitën e nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”* dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, duke pasur parasysh Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. protokoli 265/2020 i datës 02.12.2020. Në kontekst të kësaj gjykata konstaton se për kërkesat mujore siç janë pagat, përlllogaritja e kamatës bëhet për secilën kërkesë mujore veç e veç të arritur për pagesë, mirëpo në rastin konkret është llogaritja e kamatës fillon nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë 15.02.2022, sipas kërkesës së palës paditëse, e në harmoni me pikën XVII të Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i të autorizuarit të paditurit të parë sipas të cilin nga data 24.12.2012 është aprovuar Rregullorja për shtesa dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil andaj rrjedhimisht me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar vendimet paraprake të Qeverisë në lidhje me shtesat e kësaj natyre, për shkak se, siç gjykata ka konstatuar më lartë me shkresat e Ministrisë së Administratës Publike me nr.protokoli 619 e datës 06.02.2014 dhe me nr.3666 e datës 02.07.2014, të administruara si prova nga gjykata, vërtetohet se ky institucion bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.02/39 të datës 08.10.2008, ka miratuar shtesat në pagë për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare në fushën e Teknologjisë Informative në dy raste. Për më tepër gjykata thekson se edhe me dispozitat e Rregullores nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, por edhe me aktet tjera të miratuar pas kësaj rregullore është paraparë shtesa për kushtet e tregut të punës në fushën e teknologjisë informative.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe deklaratimet e organit të paditur në këtë procedurë gjyqësore, mirëpo gjykata erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par.2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:030501
Datë: 16.10.2024
Numri i dokumentit: 06308825

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.315/2022, datë 20.09.2024

G j y q t a r i
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.